



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

21.07.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Mirembajtja e varrezave publike dhe e deshmoreve**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbime të mirëmbajtjes së varrezave 98371111-5

VLERA E FONDIT LIMIT: **4.166.655 (kater milion e njeqind e gjashtedhete e gjashte mije e gjashteqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Korçë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023,2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 40 % vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në zbatim të ligjit nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomikë.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ne kuader te vleresimit te ofertave ne menyre sa me te drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktimit, vlerësimi i përvojës të mëparshme të vërtetohet me paraqitjen e kontrates se bashkepunimit apo marreveshjen e nenkontraktimit si dhe me Kontratën bazë dhe aktin e miratimit te nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Dokumenta keto te nevojshme per te vleresuar lidhur me punet konkrete qe ka kryer OE si anetar i BOE,apo si nënkontraktor. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta kete çdo kompani në dosjen e saj, per rrjedhoje nuk mund te sjelle kufizim te pjesmarrjes se OE ne tender as ne menyre direkte dhe as ne menyre indirekte.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me Licensë për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B)

Argumentimi “Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Licensa e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B) eshte vendosur per shkak se ne preventiv eshte parashikuar pastrimi,heqja dhe transporti i mbeturinave

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Kategoria Klasifikimi Emertimi i kategorise

N.P. 12 A Punime të inxhinierisë mjedisore

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, VKM Nr 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi” Ky kriter eshte vendosur me qellim qe te vertetohet se per vertetuar se operatoret ekonomike qe do te marrin pjese ne kete procedure prokurimi disponojne licencen profesionale te zbatimit per realizimin e punimeve objekt i kontrates.

Kategoria dhe klasifikimi eshte vendosur duke u bazuar ne punimet e parashikuara per tu realizuar ne preventivin e punimeve dhe vleren e tyre.

2.2.4 Një punësim mesatar i të paktën **8 personave, per muajin e fundit te deklaruar** nga data e hapjes se ofertave dokumentuar kjo me vertetimin e kontributeve te sigurimeve shoqerore e shëndetësore leshuar nga Administrata tatimore .

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: “Kriteri i mesiperm u vendos bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ky kriter u vendos me qellim qe te vertetohet se operatoret ekonomike kane fuqine punetore te nevojshme per realizimin e kesaj kontrate.”

Eshte vendosur kriteri per 8 persona per arsye se per kryerjen e sherbimeve te percaktuara ne preventiv nevojiten te pakten: 1 shofer, 3 punonjes per sherbimin e perkujdesjes gjate nates dhe 4 punonjes per mirembajtjet e tjera."

2.2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronesia
Kamion me kapacitet mbajtes deri ne 5 ton	cope 1	ne pronesi ose me qera

Në rast se është në pronësi duhet të paraqiten: çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit per mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

Në rast se është me qera duhet të paraqiten: kontrata e qirasë vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, e shoqeruar me çertifikatën e pronësisë, lejën e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit per mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

(Ne rastin e mjeteve te marra me qira nga operatoret ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022, referuar dokumentacionit (leje qarkullimi, çertifikate e transportit te mallrave) , mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet.)

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: “Kriteri i mesiperm u vendos bazuar ne neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter u vendos me qellim qe te vertetohet se operatori ekonomik ka mjetet e nevojshme per realizmin me sukses te kontrates per arsye se ne preventiv eshte parashikuar zeri transport mbeturinash.”

Bazuar ne nenin 28 të Udhezimit Nr.15, datë 24.7.2007 “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR”i ndryshuar, “Kamionët me kapacitet transportues nën 1500 kg nuk certifikohen për transport mallrash brenda vendit.”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Fondi limit, sasite, termat e references dhe specifikimet teknike jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdhrin e Kryetarit te Bashkise Nr 650 date 12.06.2025 sipas procesverbalit te mbajtur prej tyre.

Specifikimet teknike të shërbimeve objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për këtë shërbim në kushtet kur kontrata e lidhur në vitin 2024 ka përfunduar. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punes bëhen pjesë e dokumentave të tenderit.

NJËSIA E PROKURIMIT